

Pyetësor për fondet e sponsorizimit në kuadër të projektit me përgjegjësi sociale “NLB Sporti për të Rinjtë”

PREZANTIMI

NLB Sporti për të Rinjtë është një projekt afatgjatë i NLB-së për përgjegjësi sociale, në kuadër të të cilit NLB Banka sh.a. ofron mjete financiare dhe mbështetje për klubet sportive në mbarë Kosovën, të cilat i nxisin të rinjtë drejt aktivitetit fizik dhe një stili aktiv të jetesës, si dhe me përkushtimin e tyre kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në zhvillimin e një shoqërie të shëndetshme dhe të përgjegjshme.

Përmes projektit NLB Sporti për të Rinjtë, synojmë t'i inkurajojmë të rinjtë t'i rikthehen natyrës, palestrave dhe fushave sportive, ku mësojnë të fitojnë, por edhe t'i pranojnë humbjet me dinjitet, të ngrihen përsëri dhe të vazhdojnë përpara me edhe më shumë vullnet dhe përkushtim. Në kuadër të Akademisë, klubeve u mundësojmë qasje në njohuri dhe përvoja shtesë, si dhe shkëmbim mendimesh, të cilat janë të rëndësishme për veprimtarinë dhe zhvillimin e tyre. Në sezonin 2026/2027, NLB Banka sh.a. do të mbështesë sportistët e rinj në klubet dhe organizatat sportive në mbarë Kosovën, në disiplinat sportive që përbëjnë shtyllat kryesore të mbështetjes sonë edhe në nivelin e sportit profesionist: skijim, futboll, hendboll, pingpong, volejboll, skijim, basketboll dhe not.

Aplikimet (Pyetësorët) për mbështetje financiare në kuadër të projektit NLB Sporti për të Rinj pranohen deri më **30 shtator 2026**.

Pyetësori ka për qëllim prezantimin e veprimtarisë së klubit apo organizatës sportive, mbi bazën e të cilit do të përzgjidhen përfituesit e sponsorizimit. Banka i ruan të dhënat në përputhje me rregullat dhe direktivat për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave. Me nënshkrimin e saj, personi përgjegjës garanton vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara.

Emri zyrtar i organizatës:

Adresa zyrtare dhe vendi:

Tatimpaguesi (dhe numri fiskal):

po jo Nr. fiskal

Përfaqësues ligjor:

Personi kontaktues, numri i telefonit, adresa e email-it:

Personi kontaktues, numri i telefonit dhe adresa e email-it:

Faqja e internetit, faqja në Facebook, Instagram dhe rrjete të tjera sociale:

Disiplina sportive:

Në kuadër të projektit NLB Sporti për të Rinjtë, mbështesim klubet në disiplinat sportive të cilat prej vitesh i ndjekim dhe i mbështesim edhe në nivel profesional.

Hendboll	Volejboll
Futboll	Basketboll
Skijim	Ping Pong
Tenis	Not

Rajoni

Prishtinë
Prizren
Mitrovicë
Pejë
Gjakovë
Ferizaj
Gjakovë
Podujevë

AKTIVITETET

1. Përshkrimi i veprimtarisë:

2. Organizimi:

- Nr. anëtarëve në sezonin aktual prej tyre staf trajner
- Nr. anëtarëve në sezonin e kaluar prej tyre staf trajner

- Prezantimi i kategorive/ekipeve të veçanta:

Emri i grupit						
Numri i anëtarëve						
Numri i trajnerëve						
Numri i stërvitjeve në javë						
Kohëzgjatja e stërvitjeve						
Përfshirja në sistemin e garave numri i anëtarëve						

- Listoni vendet nga të cilat vijnë anëtarët:

- Sa orë në javë u mundësoni të rinjve të stërviten në klub? Sa orë aktivitet fizik në javë u rekomandoni të rinjve? Në çfarë mase marrin pjesë të rinjtë në këto aktivitete?

- A mund të stërviten edhe prindërit njëkohësisht me fëmijët?

po

jo

- A keni trajnerë të kualifikuar edhe për grupet më të cenueshme (personat me aftësi të kufizuara, personat me nevoja të veçanta, etj.)? Nëse po, për cilat grupe dhe në çfarë mënyre i zhvilloni stërvitjet?

po

jo

3. Programet sportive (stërvitjet):

- Përshkruani mënyrën e zhvillimit, qëllimin dhe objektivat e secilit program (stërvitjeje):

- Listoni realizuesit e programit – trajnerët (emri, niveli i arsimimit, kualifikimi si trajner, referencat dhe numri i viteve të përvojës si trajner):

- A ndjekin realizuesit e programit trajnime ose edukime të mëtejshme? Nëse po, ku dhe në çfarë mënyre?

- Nëse promovoni sportin garues, përshkruani sukseset e arritura.

4. Dukshmëria:

- Listoni aktivitetet, ngjarjet publike ose kampet që organizoni (ku dhe kur zhvillohen, qëllimi, numri i pjesëmarrësve, numri i përafërt i vizitorëve dhe rëndësia e tyre në komunitet):

- Listoni mediat që përdorni për njoftime, paralajmërime dhe komunikime të tjera që lidhen me klubin dhe programet tuaja. Çfarë komunikoni kryesisht dhe sa shpesh?

- Përshkrimi i hapësirës ku zhvillohen garat (mundësia për vendosjen e materialeve promovuese).

5. Edukimi mbi vlerat dhe aftësitë

- A promovoni programe, përveç aktivitetit fizik, edhe zhvillimin e vlerave dhe aftësive të tjera?

- Përshkruani mënyrën se si e promovoni dhe kultivoni frymën e fair-play.

- A keni rregullore të fair-play? Përshkruani se si zbatohen dhe si reflektohen në praktikë, si në fushën e lojës ashtu edhe jashtë saj.

6. Përfshirja e palëve të tjera të interesit

- A janë prindërit të përfshirë në program? Nëse po, përshkruani mënyrën se si janë të përfshirë.

- Përshkruani mënyrën se si bashkëpunoni me palë të tjera (shkolla, konkurrentë, media, etj.):

7. Aktivitete shtesë

- A jeni të gatshëm që një herë në vit të organizoni trajnime për stafin e trajnerëve në kuadër të programeve përmes të cilave promovojmë dhe bashkëkrijojmë rolin e sportit me përgjegjësi sociale dhe parimet e fair-play?

po

jo

- A jeni të gatshëm që një herë në vit të organizoni një aktivitet me përgjegjësi sociale në bashkëpunim me Degën e NLB-së dhe komunitetin lokal (anëtarët tuaj, prindërit, etj.)?

po

jo

Informacione më të detajuara mbi mënyrën se si banka i trajton të dhënat personale dhe mbi të drejtat tuaja janë në dispozicion në <https://www.nlb-kos.com/sq/politika-e-privatesise/mbrojtja-e-te-dhenave-personale>, përkatësisht në dokumentin “Informacione të përgjithshme mbi përpunimin e të dhënave personale”.

Personi përgjegjës për saktësinë
e të dhënave:

Prishtinë, _____

Nënshkrimi i personit përgjegjës: _____